

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	13.01.2025	Ankesë për dëmtim makine gjatë procesit të kualidimit	20.01.2025	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bëri verifikimet e duhura pas kërkesën/ankesën të sjell nga ana juaj, për këtë bëjmë me dije se:</p> <p>Nuk rezultojnë që specialisti i kontrollit teknik të ketë kryer veprime të cilat mund të kenë shkaktuar dëmtim të tillë në xhamin e mjetit tuaj. Procedura e kontrollit teknik shërben për të konstatuar difekte apo mangësi të mjetit të dukshme apo të padukshme të mjeteve.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	0
2	24.01.2025	Kërkesë për informacion	30.01.2025	<p>Në vijim të emailit tuaj, lidhur me kërkesën për informacion, ju sqarojmë si më poshtë:</p> <p>Referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 19.12.2019 “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve”, shtojca V, mbi informacion për të gjitha linjat interurbane mbi fluksin e udhëtarëve në terminal të përlogaritura në volum ditor dhe volum vjetor hyrje-dalje për të gjitha linjat interurbane, përkatësisht për Bashkinë Lushnje rezultojnë:</p> <p>Volumi ditor hyrje-dalje të udhëtarëve në terminal është 2.422 persona;</p> <p>Volumi vjetor hyrje-dalje të udhëtarëve në terminal është 884.030 persona.</p> <p>Shënim: Këto të dhëna rezultojnë nga një studim i vitit 2016 nga INSTAT, organi shtetëror përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore në vend.</p> <p>Nga verifikimi në sistemin eTransport, rezultojnë se ka 22 (njëzet e dy nise) në ditë nga Tirana në Lushnjë referuar orareve të përcaktuara në licencat e subjekteve dhe kapaciteti mesatar i vendeve të autobusëve që operojnë në këtë linjë është 28 vende.</p> <p>Për sa i përket kërkesës për informacion për transportin publik hekurudhor, ju bëjmë me dije se nuk është në objektin e veprimtarisë së DPSHTRR-së transporti hekurudhor.</p> <p>Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>	E deleguar	0
3	29.01.2025	Kërkesë për informacion	04.02.2025	Shkresë Nr. 1832.1 datë 04.02.2025	E plotë	0

4	29.01.2025	Kërkesë për informacion	13.02.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, Ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Tarifat e udhëtimit në transportin ndërqytetës janë të caktuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 21.02.2024 "Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus".</p> <p>Në zbatim të Urdhërit nr. 318, datë 02.11.2020 "Për delegim kompetence", të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ushtron kompetencën e licencimit të subjekteve dhe certifikimit të mjeteve për operimin në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus por nuk ka kompetenca për kontrollin e tyre gjatë operimit në rrugë.</p> <p>Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 26.07.2018, ka krijuar Task Forcën e Transportit Rrugor, organ i posaçëm për kontrollin në terren të shoqërive që kryejnë transport udhëtarësh.</p> <p>Sa më sipër, nisur nga fakti se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR-ja) nuk ka kompetenca kontrolli në rrugë për shoqëritë që kryejnë transport udhëtarësh, kërkesa u dërgua nga ana jonë për verifikim pranë Task Forcës së Transportit Rrugor për verifikime të mëtejshme dhe marrje masash në rast konstatimi të shkeljeve.</p> <p>Faleminderit dhe punë të mbarë.</p>	E deleguar	0
5	03.02.2025	Kërkesë për të dhëna mbi konsumin e Energjisë në sektorin e Transportit në Bashkinë Elbasan	12.02.2025	<p>Makina pasagjerësh - të dhëna të tjera Numri total i makinave + motoçikletave në qytet57640 Pjesa e flotës që është më pak se 2 vjeçare1.50% Pjesa e flotës plotësisht elektrike (pa përfshirë hibridet)0.20%</p> <p>Autobusët - të dhëna të tjera Numri i autobusëve në flotën e autobusëve të qytetit637 Pjesa e flotës së autobusëve si autobusë plotësisht elektrikë (pa përfshirë hibridët)0 Pjesa e flotës së autobusëve - me bazë biologjike0</p>	E plotë	0
6	10.02.2025	Kërkesë për informacion- Aplikimi 204832	18.02.2025	Nr. 2830/1 Prot., datë 18.02.2025		0
7	10.02.2025	Kërkesë për informacion	21.02.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, protokolluar me tonën nr. 2831 prot., datë 10.02.2025, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion statistikor mbi disa shërbime në DPSHTRR, ju sqarojmë respektivisht për secilën pyetje si më poshtë:</p> <p>Sa është numri i kontratave noteriale të shitblerjes së automjeteve gjatë viteve 2023 dhe 2024?</p> <p>Përgjigje - DSPHTRR për shërbimin “ndërrim pronësie” nuk administron të dhëna statistikore nëse ky shërbim kryhet me kontratë noteriale, faturë me TVSH, akt trashëgimie, urdhër transferimi kapital, etj</p> <p>Sa është numri i targave të reja të regjistruara gjatë viteve 2023 dhe 2024?</p> <p>Përgjigje respektivisht viti 2023 – 129,655 targa të reja; viti 2024 – 150,742 targa të reja.</p>	E plotë	0

8	17.02.2025	Kërkesë për informacion	19.02.2025	E plotë	0
---	------------	-------------------------	------------	---------	---

Në përgjigje të email-it tuaj datë 17.02.2025, protokolluar me tonën nr. 3498 prot., datë 17.02.2025 “Kërkesë për informacion”, ku kërkonti informacion për formatin zyrtar të gjobës për kalimin e afatit për ndërrim pronësie mjete (jo targe), vlerën e përcaktuar të gjobës, si dhe nëse ka urdhër të brendshëm të DPSHTRR apo MIE për përcaktimin e formatit dhe vlerës së kësaj gjobe, ju sqarojmë se: Në zbatim të pikës 1, të nenit 93, të Ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore ose në rastin kur u jepen në përdorim të tjerëve apo kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, paraqitet pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera”, si dhe në pikën 3, të këtij neni parashikohet: “Cilido që nuk respekton dispozitat e përcaktuara nga ky nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë”. Në mbështetje të pikës 2, të nenit 10, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtje administrative”, parashikohet se: “Në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, atëherë, për qëllim të marrjes së vendimit për kundrvajtjen administrative, organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundrvajtjes, përveç parimeve të parashikuara nga neni 18 i këtij ligji, miraton edhe metodikën apo parime të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet për përcaktimin e vlerës së gjobës, për rastet e kundrvajtjeve, për të cilat parashikohet i njëjti dënim”. Në interpretim të pikës 2, të nenit 10, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, duke qenë se gjoba është në kufijtë minimalë dhe maksimalë, me qëllim shmangien e keqinterpretimit dhe zbatimit në mënyrë të unifikuar nga të gjithë punonjësit e drejtorive rajonale në varësi të DPSHTRR-së, vlera e saj për automjete, motomjete dhe rimorkio, është si më poshtë: për shkelje të afatit mbi 30 ditë deri në 90 ditë kalendarike në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë; për shkelje të afatit mbi 90 ditë deri në një vit në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë; për shkelje të afatit me më shumë se një vit në shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë. Gjoba e ndryshimit të pronësisë të mjeteve rrugore arkëtohet nga DPSHTRR në zbatim të ligjit sipërcituar, dhe në zbatim të tij, DPSHTRR ka krijuar formatin e gjobës (bashkëngjitur), format i cili është i informatizuar ku faturohet dhe arkëtohet nga sistemi informatik.

Gjoba përmban:
 Nr. serial që gjenerohet automatikisht nga sistemi;
 Të dhënat personale të klientit;
 Të dhënat e kryesore të mjetit si shasi, viti i prodhimit, tipi i mjetit, etj;
 Vlera e gjobës sipas përlllogaritjes së afatit;
 Data e arkëtimit të gjobës.

Për sa më sipër, DPSHTRR vepron në zbatim të akteve ligjore për gjobën e ndryshimit të pronësisë së mjetit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

9	12.03.2025	Kërkesë për informacion	19.03.2025	<p>Në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ju bëjmë me dije se:</p> <p>Referuar nenit 12 të Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës (MIE) Nr. 9, datë 14.04.2022 "Për aktivitetin e autoshkollave", në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi mjete, personi i interesuar ka të drejtë të marrë dhe përkthyes të licencuar. Në rast se testi teorik zhvillohet në gjuhë të huaj nuk duhet përkthyes.</p> <p>Sa më sipër, për të marrë pjesë në provën e kontrollit të njohurive teorike si përkthyes, ju duhet të paraqiteni me dokument identifikimi të vlefshëm dhe me licensën e përkthyesit (ose kopje të njehsuar me origjinalin nga noteri) pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) së bashku me kandidatin në datën dhe orën e përcaktuar nga DRSHTRR sipas grafikut javor të testimeve teorike, për autoshkollën ku është i regjistruar kandidati.</p> <p>Faleminderit,</p>	E plotë	0
10	19.03.2025	Kërkesë për informacion	25.03.2025	Shkresë Nr. 5963/1 Datë 25.03.2025	E plotë	0